

**STATUTI  
I  
SHOQERISE**

**"DINELI CONSTRUCTION" SH.P.K**

**KREU I-re**

**Dispozita te Pergjitheshme**

**NENI 1.**

Ne Tirane sot me date 02/11/2020 eshte themeluar Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"DINELI CONSTRUCTION" SH.P.K** , sipas kontrates dhe ne pershtatje te ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruara nga ortaket e saj.

**1-Z.Shefik NELI**, atesia Pajazit, i datelindjes 15.01.1970, lindur në Diber, banues në Tiranë (Shqipëri), shtetas Shqiptar, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numer personal H00115162L;

Baza ligjiore: Shoqeria do te jete person juridik me regjistrim ne QKB sipas nenit 22 te ligjit Nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendern Kombetare te Biznesit" e ne baze te Ligjit Nr 9901 te dates 14.04.2008 "PER TREGETARET DHE SHOQERITE TREGTARE. Shoqeria do te gezoje te drejtat si person juridik dhe do te filloje veprimtarine e saj nga data e regjistrimit ne Q.K.B-

Emertimi i shoqerise eshte **"DINELI CONSTRUCTION" SH.P.K** . Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti eshte krijuar me mjetet ne pronesi private te themeluesve te saj. Ajo regullon poziten juridike te themeluesve dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise. Shoqeria **"DINELI CONSTRUCTION I" SH.P.K** eshte person juridik shqiptar e fiton kete te drejte qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne Q.K.R

Shoqeria ka vullen e saj ne forme te zakonshme shkruar Shoqeria


**"DINELI CONSTRUCTION" SH.P.K** kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe te rentabilitetit.

**NENI 2.**

**Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete:**

3.1. 1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktivitetit tregtar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Shoqëria ka si objekt veprimtarie aktivitetin si në vijim:





Veprimtari Ndertimi, konstruksione ndertimi, restaurimin e ndërtesave, Tregëtimin me shumicë dhe pakicë, prodhimin, instalimin e materialeve të ndërtimit në përgjithësi, të pllakave të dyshemeve si dhe për veshjet e mureve, të aparaturave e materialeve për impiante higjienikë dhe sanitare, të impianteve hidraulike, të impianteve të ngrohjes dhe të kondicionimit, të materialeve që përdoren për veshjen e banjove, të mbulesave e materialeve që përdoren për mbulimin e banesave si dhe të paneleve izolues – termikë dhe akustikë, të rrëshirës termoplastike e materialeve të përbëra, të prodhimeve siderurgjike, të materialeve gjysëm të përpunuara që përdoren në këtë fushë. Prodhimin, tregëtimin dhe instalimin e impianteve që lidhen me sektorin e ndërtimeve ekologjike apo të ndërtimeve të përbëra nga materiale që kursejnë energji. Tregëtimin me shumicë dhe pakicë, importimin, eksportimin, prodhimin, dhënien me qira, mirëmbajtjen dhe riparimin të çdo lloji makinerie apo mjeti që përdoren për ndërtimin apo punimeve për heqjen e dherave, përfshirë skelerina, ura etj. Blerjen, shitjen, kryerjen e çdo veprimi përsa i përket materialeve të përmendura në aktivitetin e shoqërisë.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj dhe në kryerjen e veprimeve që kanë lidhje me pasuri të paluajtshme si blerjen, shitjen, administrimin e banesave sociale, aktivitetin e ndërmjetësimit në fushën e ndërtimit, marrjen pjesë në konkurse apo tendera të ndryshëm, përsa i përket furnizimit me materiale të cilat parashikohen në aktivitetin e shoqërisë.

Shoqëria mund të kryejë veprime që lidhen me aktivitetin e saj tregtar, industrial për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme që lidhen me objektin e aktivitetit të saj, të japë garanci dhe për të tretët.

### **NENI 3.**

Shoqëria e ka Seline e saj ne Tirane , **Adresa Rruga Frederik Shiroka Godina ALBA Hyrja 1 Zona Kadastrale nr 8210 nr pasurie 5/269-N34**

Adresa per komunikim elektronik eshte:


.....

**Faqe web.....**

Ajo mund te çele filiale ,dege dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

### **NENI 4.**

Shoqëria pergjigjet per detyrimet e saj me fondet e veta.





## KREU II-te

### *Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve:*

#### NENI 5.

##### *Ortakuet gezojne keto te drejta kryesore:*

- Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne kontraten dhe statutin e saj.
- Marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarine e shoqerise, si dhe me te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria, bilancet si dhe llogarite ekonomike, etj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese se Ortakeve.
- Te heqi dore nga shoqeria.
- Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.
- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tije ose vete.
- Te kerkoje t'i jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.
- Te beje propozime dhe t'i paraqesi ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emeruje dhe te shkarkojne perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

#### NENI 6.

##### *Ortaket kane keto detyrime kryesore:*

- Te depozitojne kuoten e tyre dhe kuotat suplementare ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ata.
- T'i japin shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
- Te kryejne detyrat per realizimin e objektiveve dhe te funksioneve te shoqerise.
- ortaket kane te drejte te heqin dore nga shoqeria, duke i njoftuar vendimin e tyre asamblese se ortakeve ne rast shtimi te ortakeve 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes.
- Heqja dore nuk i liron ortaket nga detyrimet e marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e shoqerise ndaj ortakut.





- Ti japin shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryejne sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.
- Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon ortakët te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesia. Ata nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tej kapitalit themelor ku ata kane marre pjese.

### **KREU III-te**

#### **Kushtet Ekonomike**

##### **NENI 7.**

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes. Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

##### **NENI 8.**

Llogarite vjetore inventari, raportet operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asamblea. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

##### **NENI 9.**

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, vihet nje kapital baze qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

##### **NENI 10.**

**Kapitalit themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke zoterohet nga ortakët themelues**

**Numeri i kuotave eshte 1 (nje), pjesemarrja ne Kapital e shoqerise per ortakun e vetem te shoqerise eshte**

- **Shefik Neli** është ortak i vetem i shoqërisë e zotëron një (1) kuote të barabartë me 100,000 (njëqindemije) lekë që i korrespondon 100 (njëqinde) përqinde të kapitalit të Shoqërisë.

##### **NENI 11.**





Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave i marrin ortaket themelues.

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj.perfitohen prej ortakeve themelues te kesaj shoqerie.

Ortaket perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te tij ortaket kane te drejten e rritjes se tije.

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial. Shoqeria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektin e veprimtarise qe ajo kryen. Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare. Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

#### **NENI 12.**

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejte te perdorimit dhe disponimit te kesaj pasurie, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen. Shoqeria gezon te drejttat per mbrojtjen e pasurise se saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **NENI 13.**


E ardhura bruto e shoqerise, pasi zbritet amortizimi i te gjithe pasurise se lujteshme e te palujteshme, sipas afateve te caktuara, kuotat qe kane te bejne me kredite per investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para apo ndihmese e energjine si dhe shpenzimet e pergjithshme te saksioneve te shoqerise dhe ato per qellime te tjera prodhuese e joprodhuese, i takojne ortakeve te shoqerise.

#### **KREU IV-te** **Administrimi**

#### **NENI 14.**

#### **Organi vendimor i shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve.**

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga administratoret, nga eksperti kontabel i autorizuar. Mbledhja e Asamblese mblidhet dhe merre vendime ne baze te nenit 86 dhe 87 te ligjit Per Shoqerite Tregtare.





Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e Asamblese mund te jete e **zakonshme** ose e **jashtezakonshme**.

**Asambleja e zakonshme** vendos :

1. Per ceshtje te tilla si emerim ose shkarkimin e personelit Injnierio-teknik sipas strukturave te ngritura nga shoqeria ,ekspertin kontabel te autorizuar dhe likuiduesit, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, per :
2. Miratimin e programit vjetor te veprimtarise se shoqerise.

**Asambleja e jashtezakonshme** vendos:

Per ceshtje te tilla si ndryshimin e statutit, zvogelimin e pjeseve te kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar , shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera, mbylljen e shoqerise para kohe, per fitimin dhe rezultatet


Asamblea thirret se paku nje here ne vit, duke lajmeruar me shkrim 30 dite perpara.

#### **NENI 15**

Asamblea e Ortakeve merr vendime per cdo aspekt te veprimtarise se shoqerise

#### **Kompetencat ekzekutive te Asamblese se Ortakve te shoqerise jane:**

1. Percaktimi i te drejtave kryesore te veprimtarise se shoqerise.
2. Ndryshimet ne emertesen e prodhimit qe do te realizohet dhe te punimeve qe do te kryhen, qe jane pjese perberese e objektit te veprimtarise se shoqerise.
3. Propozimet e nevojshme per ndryshimet ne kapitalin baze te shoqerise.
4. Percaktimi i regjimit dhe i kushteve te zbatimit te parimeve te llogarise ekonomike.
5. Percaktimi i rregullave dhe i normave, qe perkufizojne raportet me gjirin e shoqerise, duke perfshire edhe kuadrin e personelit.
6. Percaktimi i struktures se aparatit te shoqerise.
7. Percaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese ndermjet perfaqesive te ortakeve.
8. Emertimi dhe zevendesimi i Administratorit te pergjithshem te shoqerise.
9. Krijimi i organeve te tjera te domodoshem per realizimin e objektiveve te shoqerise.
10. Percaktimi i madhesise se kuotave per formimin e kapitalit baze te shoqerise.
11. Paraqitja e propozimeve per rregullimin, krijimin dh perfitimin nga fondet e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe percaktimi i rregullave per shlyerjen e borxheve.
12. Marrja e vendimit per krijimin e filialeve te degeve e te perfaqesive si dhe per cedimin e veprimtarise se tyre.
13. Percaktimi i rregulloreve per proceduren e punes te administrates.
14. Pergatitja e propozimit per pushimin e veprimtarise se shoqerise.
15. Perzgjedhja e antareve per komisionin e likujdimit te cilet emrohen dhe rievokohen nga Asamblea e Ortakeve.
16. Kryerjen e veprimtarive per likujdimin e llogarive, qe i perkasin ortakut doreheqes te shoqerise.





17. Marrjen e vendimit per kerkimin dhe perdorimin e kredive afatgjata.


**NENI 16.**

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj.

**Ne shoqerine "DINELI CONSTRUCTION" SH.P.K** Administratore i shoqerise do te jene **z. Shefik Neli** i cili ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithë veprimtarine e saj. Me miratimin e ortakeve mund te emrohen administrator dhe perfaqesues te shoqerise . Administratori emerohen per nje kohezgjatje prej pese vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratoret jane pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.

**Kompetencat e administratoreve ne shoqeri jane:**

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te beje propozimet e nevojshme ne mbledhjen e asambles kur lind nevoja e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te krijoje organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Te propozoje ne mbledhjen e asamblese per krijimin e njesive, srukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
- Te pergatise propozimet per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqesin ato Asamblese per miratim.
- Te perzgjedhi ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likujdimit dhe te paraqesin propozimet per miratim ne asamble.
- Te siguroje zbatimin e perpikte te vendimeve te asamblese.
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.
- Organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raporton per to ne perputhje me programet e planet e pergjithshme, administron pasurine e shoqerise, duke perfshire ketu mjetet financiare, brenda caqeve te vendimeve te marra nga organi administrativ i shoqerise.
- Drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve te degeve e te perfaqesive.
- Perfaqson shoqerine perpara te treteve si gjykate,etj.
- Nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te shoqerise dhe siguron venien e tyre ne jete.
- Merr te gjitha vendimet qe kane te bejne me ato veprimtari te shoqerise, qe nuk jane ne kompetence ekzekutive te Asamblese se Ortakut.





- Raporton dhe i pergjigjet Asamblese per zbatimin e veprimtarive te shoqerise si dhe per realizimin e objektivave dhe detyrave qe jane ne kompetence te tij.
- Siguron drejtimin e shoqerise.
- Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pervec ceshtjeve qe kerkojne unanimitetin e ortakeve ose qe kane te bejne me kompetencat qe ky statut i atribuon Asamblese se Ortakut.
- Organizon zbatimin e sakte te vendimeve te Asamblese se Ortakeve.
- Ben hapjen e leter kredive ne leke e ne valute te huaj.

#### **NENI 17.**

Per te kontrolluar veprimtarine financiare te shoqerise e te filialeve te saj krijohet komisioni i revizionimit kontabel.

Kryetari dhe antaret e ketij komisioni emerohen nga Asamblea e Ortakeve. Kryetari i komisionit emerohet per cdo mandat nga Asamblesa.

Komisioni i Revizionimit kontabel perbehet nga 3-5 vete dhe qendron ne detyre per nje periudhe prej tre vjetesh.

Kryetari dhe antaret e komisionit nuk mund te jene ne varesi te shoqerise ose filialeve te saj.

Komisioni i Revizionimit kontabel eshte pergjegjes per veprimtarine e vet perpara Asamblese se Ortakeve dhe eshte i detyruar ti paraqese asaj cdo vit raport per kontrollet e bera si dhe konkluzionet per bilancet vjetore.

#### **NENI 18.**

##### **Mardheniet e punes ne shoqeri.**

Marrdheniet e punes ne shoqeri e filiale, ne dege e perfaqesite rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut si dhe nepermjet kontrates se punes Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes. Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

Kushtet dhe menyra e marredhenies se punes.

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.

Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.

Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.

Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e Punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

Pushimi i marredhenies se punes.

Paga e punes se punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Per te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e rrethit Gjyqesor Tirane.



## KREU V-te

### Mbyllja e Shoqerise:

#### NENI 19.

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin te ortakut, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel ose kur ortaku heq dore nga shoqeria si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise (kontrata).Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

*Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i pacaktuar .*

#### NENI 20.

##### Kur shoqeria likujdohet:

Asambleja e ortakeve emeron likujdatorin, te cilit i paraqitet bilanci dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij raporti te hartuar.

Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Te ardhurat cedohen ndermjet ortakeve ne perpjetim me kuoten e vene. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena,pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

#### NENI 21.

Kur pushon veprimtaria e nje filiali ,per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakeve. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

#### NENI 22.

Ku statut hyn ne fuqi menjehere.

### ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

- Shefik NELI -

